



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

---

Numri i lëndës: 2021:114812

Datë: 06.10.2022

Numri i dokumentit: 03499418

P.nr.160/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka me procesmbajtësen Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.L nga fshati ...- Komuna e Kaçanikut, për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj me numër PP/II.nr.721/21 të datës 21.06.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar më datë 21.09.2022, publik, në praninë e Prokurores së Shtetit Mimoza Syla - Hyseni dhe të pandehurit, mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë **06.10.2022** përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: B.L nga Fshati ... - Komuna e Kaçanikut, i lindur më datë ..., nga i ati Xh... dhe e ëma H..., e gjinisë A., me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, prind i 4 fëmijëve, punon me ndërtimtari në firmën "...", i gjendjes së mesme ekonomike, shtetas i Republikës e Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 10.05.2021, rreth orës 16:00, i mllefosur për shkak se policët V. K. dhe A. B., ndalin dhe për shkak se kamioni kishtë një targë të një kamioni tjetër dhe nuk kishtë regjistrim

iu shqiptojnë një tiketë shoferit të kamionit të të pandehurit, të cilin e ngiste A. T., në ato momente vjen i pandehuri që të sjell librezën e kamionit dhe kur sheh se personat zyrtar ishin duke i shqiptuar gjobë irritohet dhe fillon duke i sharë dhe kërcënoj policët gjatë arrestimit dhe rrugës për në stacionin policor në Kaçanik, me fjalët ‘‘Me juve do të drejtohem më vonë, keni me pa se kush jam unë, a jav merr mendja se dal naj herë, keni me më njoft se kush jam, sju lë të qetë ka me u hakmarrë ndaj juve’’.

-Me të cilin veprim ka kryer veprën penale Kanosja nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Andaj duke u bazuar në dispozitën e lartcekur dhe nenin 2, 17, 38, 39, 42, 43, 44, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 365 dhe 453 paragrafi 4 të KPPK-së e:

## GJYKON

I. Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve (Nëntëdhjetë ditëve), ku në mbështetje të nenit 44 të KPRK-së, dënimi i shqiptuar me burgim, me pëlqimin e të pandehurit, i zëvendësohet me dënim me gjobë prej 500 € (pesëqind euro), të cilën gjobë është i obliguar që ta paguaj në 5 këste mujore të barabarta, në afat prej 5 muajve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke llogaritur nga 1 ditë burgim për çdo 20 € (njëzet euro) të gjobës së pa paguar, nëse i pandehuri nuk e paguan këstin me kohë, mundësia e pagesës me këste revokohet.

III. Palët e dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest civil.

III. Detyrohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve procedurale dhe paushallit gjyqësor, t'i paguaj kësaj gjykate shumën prej 20.00€ dhe në emër të Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30.00€, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.721/21 të datës 21.06.2021 kundër të pandehurit të lartë shënuar për shkak të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, duke propozuar që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata duke vepruar sipas kësaj akuze caktoi dhe mbajti seancën e shqyrtimit fillestar më datë 21.09.2022.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, i pandehuri e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës për veprën penale për të cilën është akuzuar dhe ka deklaruar ka qenë momenti, e pa qëllimshme, është hera e parë që jam akuzuar, i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, ka dhënë pëlqimin e zëvendësimit të dënimit me burgim në dënim me gjobë.

Prokurorja e Shtetit duke shprehur mendimin e sajë lidhur me pranimin e fajësisë, ka vlerësuar se ekziston baza për pranimin e fajësisë së të pandehurit, ngase e njëjta është bërë konform nenit 248 të KPP-së dhe i ka propozuar gjykatës që pandehurin të e shpall fajtorë dhe t'i shqiptoj dënim sipas ligjit.

### *Vlerësimi i pranimin të fajësisë*

Pasi që i pandehuri e ka pranuar fajësinë gjatë shqyrtimit fillestar, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurores së Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 248 par 1 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: I pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; Pranimi është bërë vullnetarisht, pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokuroria e Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; Akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin juridik gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Kanosje nga neni 181 paragrafi 3 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, në mënyrë kohë dhe vend si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

### *Rrethanat për matjen e dënimit*

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të nenit 69, 70 të KPRK-së, si rrethanë posaçërisht lehtësuese gjeti pranimin e fajësisë në shqyrtim fillestar, është hera e parë që është akuzuar dhe i ka premtuar Gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë më vepra penale, ndërsa si rrethanë rënduese nuk gjeti përpos veprimeve të cilat e përmbushin figurën e veprës penale

Gjykata, të pandehurit i shqiptoi dënim duke e marrë për bazë minimumin dhe maksimumin dhe qëllimin e dënimi, gjendjen ekonomike të të pandehurit dhe duke u bazuar në rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe është i bindur se edhe me një dënim të tillë, do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 38 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e saj dhe të autorit të saj, që do të shërbej në parandalimin e kryesve nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe do të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimit.

### *Kërkesat pasurore juridike*

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil është marrë në bazë të nenit 463 paragrafi 2 të KPRK-së

### *Shpenzimet e procedurës*

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, u detyrua i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj pranë kësaj gjykate shumën prej 20.00€ dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 39 par 3 pika 3.1 të ligjit Ligji Nr. 05/L -036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit gjykata e obligoi të pandehurin të paguajnë shumën prej 30.00€ Fondit për

Kompensimin e viktimave të krimit dhe atë në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Mbi bazën e të dhënave si më lart, në bazë të neneve 248 dhe 365 të KPPK-së, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE FERIZAJ**

Dega në Kaçanik

P.nr.160/21 datë 06.10.2022

Procesmbajtësja:

Suzane Rudi

Gjyqtari:

Burim Çaka

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.